



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

**Raport për të Kryer Procedurat e Dakorduara
në përputhje me Urdhërin Nr.94, datë 27.03.2018
“Mbi Raportimin Financiar të Shoqërive të Ujësjetësive në Republikën e
Shqipërisë”**

[Emri i Shoqërisë së Ujësjetësive]

[Periudha për të cilën kryhen procedurat]

Formati i Raportit është i miratuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike

Ky raport është subjekt i Kontrollit të Cilësisë nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike

Përmbajtja

1	Raporti i gjetjeve faktike	3
2	Informacion në lidhje me Kontratën	5
3	Procedurat e kryera dhe Gjetjet Faktike	6
	Aneksi 1 Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyra e Cash-Flow, Buxheti vjetor	11
	Aneksi 2 Fatura e Raportit të Verifikimit e faturuar nga Audituesi	11
	Aneksi 3 Letra e angazhimit midis audituesit dhe subjektit për Raportin e Verifikimit	11
	Aneksi 4 Shpalosja e informacionit të detajuar për Audituesin Ligjor, Shoqërinë e Auditimit	11
	Aneksi 5 Deklaratat e konfliktit të interesit	11
	Aneksi 6 Evidenca të lidhura me eksperiencën në ujësjellës-kanalizime	11
	Aneksi 7 Evidenca të lidhura me titujt	11
	Aneksi 8 Lista e procedurave të kryera	11

1 Raporti i gjetjeve faktike

[Emri i Titullarit]

[Emri i Ujësjesit]

[Adresa e Ujësjesit]

[Emri dhe Adresa e audituesit ligjor/shoqërisë audituese/bashkimit të operatorëve]

[Data e Raportit]

I nderuar **[Emri i titullarit]**

[Informacion i përgjithshëm mbi kontratën dhe termat e angazhimit duke shpalosur dhe periudhën raportuese]

Qëllimi

Angazhimi ynë [referim i Urdhërit nr. 94, datë 27.03.2018]. Qëllimi i këtij verifikimi [një përmledhje e shkurtuar e procedurave të dakorduara të urdhërit duke referuar aneksin e urdhërit]

Standardet dhe Etika

Angazhimi ynë është ndërmarrë në përputhje me:

- Standardin Ndërkombëtar mbi Shërbimet e lidhura (ISRS) 4400 “*Angazhimet për të kryer Procedurat e dakorduara në lidhje me Informacionin Financiar*” të shpallur nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC);
- *Kodi i Etikës për Profesionistët kontabël* të publikuar nga IFAC.

Procedurat e kryera

Ne kemi kryer procedurat e listuara në Aneksin 8 të këtij Raporti.

Duke qenë se, procedurat e kryera nga ne nuk përbëjnë një auditim ose një rishikim të bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ose Standardet Ndërkombëtare mbi Angazhimet e Rishikimit, ne nuk shprehim asnjë siguri për Raportin Financiar shoqërues.

Nëse do të kryhenim procedura shtesë ose një auditim apo rishikim të pasqyrave financiare të Përfituesit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, çështje të tjera mund të kishin ardhur në vëmendjen tone, që do të ishin raportuar për ju.

Burimet e Informacionit

Raporti paraqet informacionin që na është dhënë nga ju, në përgjigje të pyetjeve specifike ose si është marrë dhe nxjerrë nga llogaritë dhe regjistrimet tuaja.

Gjetjet Faktike

[Përmledhje kryesore e gjetjeve faktike të referuara me seksionin përkatës ku është bërë detajimi]

Ne i raportojmë detajet e gjetjeve tona faktike që rezultojnë nga procedurat që kemi kryer në Seksionin 2 të këtij Raporti.

Përdorimi i këtij Raporti

Ky raport është vetëm për qëllimin e parashtruar më lart nën çështjen “Qëllimi”.

[Referencat e kontrollit të cilësisë së BMP-së dhe përdoruesit të raportit]

Me respekt,

Audituesi:

Adresa:

Data:

2 Informacion në lidhje me Kontratën

Informacion në lidhje me kontratën	
Numri i protokollit dhe data e kontratës	
Titulli i kontratës	
Vendi	
Emri Ujësjesit	
Baza ligjore e kontratës	
Data e fillimit të kontratës	
Data e mbarimit të kontratës	
Totali të Ardhurave të Ujësjesit	
Totali Shpenzimeve të Ujësjesit	
Vlera e Kontratës së lidhur me audituesin për procedurat e dakorduara	
Numri i kësteve të faturimit	
Emri/ Emrat e Audituesit të pasqyrave financiare për pasqyrat financiare të dy viteve të fundit referuar sipas periudhave	
Audituesi	

Informacion i Përgjithshëm mbi Ujësjesin

[Vendos informacion mbi ujësjesin, strukturën e kapitalit, numrin e punonjësve, kuadrin e raportimit etj.]

3 Procedurat e kryera dhe Gjetjet Faktike

Këto procedura janë:

- 1 Procedurat e përgjithshme.
- 2 Klasifikimi dhe verifikimi i informacioneve të lidhura me shpenzimet.
- 3 Procedura të lidhura me ankesat e konsumatorëve.
- 4 Procedura të lidhura me matësat dhe regjistrat e matësave.
- 5 Procedura të lidhura me çështje të tjera.

[Përmbledhje e gjetjeve]

Tabela 1 – Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse

[Vendos pasqyrën përkatëse]

Tabela 2 – Pasqyra e Cash Flow

[Vendos pasqyrën përkatëse]

Tabela 3 – Buxheti Vjetor

[Vendos tabelën e buxhetit]

Ne i raportojmë gjetjet tona faktike që dalin nga këto procedura më poshtë.

1 Procedurat e përgjithshme

1.1 Shpenzimet faktike dhe ato të buxhetuara

Ne i kemi kuptuar termat e urdhrat nr.94 datë 27.03.2018 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë.

Ne i kemi kuptuar të gjitha anekset e urdhrat dhe formatin e miratuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

Ne kemi krahasuar shpenzimet faktike të vitit/periudhës të pasqyruara në librat kontabël me ato të pasqyruara në buxhetin e miratuar. Për këtë, ne kemi marrë buxhetin e miratuar së bashku me pasqyrat e miratuara të periudhës duke bërë rakordimet përkatëse midis librit të madh të llogarive, bilancit verifikues dhe zërave të buxhetit. Gjithashtu, ne kemi kontrolluar të gjitha ndryshimet që kanë ndodhur në zërat e buxhetit dhe kemi verifikuar miratimin e tyre.

• [Përshkrimi i gjetjeve]

1.2 Inventarizimi fizik

Ne kemi kërkuar dhe kemi marrë procesverbalin e numërimit të aktiveve afatgjata materiale në fund të vitit ushtrimor dhe kemi verifikuar rregullsinë e procesverbalit dhe procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve të komisionit që kanë marrë pjesë në numërimin fizik të aktiveve afatgjata materiale. Gjithashtu, ne kemi kryer një rakordim midis procesverbalit të numërimit me regjistrin e aktiveve afatgjata materiale të miratuar dhe librave kontabël.

Për më tepër, ne kemi kërkuar procesverbalin e numërimit të mjeteve monetare në fund të periudhës raportuese si dhe kemi verifikuar rregullsinë e procesverbalit dhe procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve të komisionit të numërimit të mjeteve monetare. Gjithashtu, ne kemi kryer një rakordim midis procesverbalit të numërimit të mjeteve monetare dhe librave kontabël.

- **[Përshkrimi i gjetjeve]**

1.3 Detyrimet e prapambetura

Ne kemi marrë informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve mbi detyrimet e prapambetura dhe kemi bërë verifikimin lidhur me rakordimin e librave kontabël analitikë (kartelat e furnitorëve), duke analizuar edhe ekzistencën e detyrimeve pa identitet. Gjithashtu, ne kemi dërguar konfirmime për të gjitha detyrimet që kanë një tepricë të barabartë ose më të madhe se 10% të totalit të detyrimeve si dhe për kategoritë specifike të parashikuara në urdhrin përkatës.

Për më tepër, ne kemi analizuar strukturën e vjetërsisë së këtyre detyrimeve të shpalosura sipas tabelës në vijim:

<i>Grupimi sipas kategorive</i>	<i>Detyrime deri në 1 vit</i>	<i>Detyrime nga 1 - 5 vite</i>	<i>Detyrime mbi 5 vite</i>
OSHEE			
Administrata Tatimore dhe Doganore			
Institucione të tjera buxhetore			
Institutit të Sigurimeve Shoqërore			
Punonjësve			
Çështje gjyqësore			
Të tjera detyrime mbi 10% të totalit			

1.3.3. Gjithashtu ne kemi verifikuar nëse ka akt-marrëveshje për shlyerjen e çdo detyrimi të prapambetur.

- **[Përshkrimi i gjetjeve]**

1.4 Plani i biznesit

Ne kemi kërkuar informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve mbi planin e biznesit të përgatitur për huamarrjet nga bankat (nëse ka) dhe krahasojmë të dhënat faktike, sipas pasqyrave financiare më të fundit, duke identifikuar diferencat në rezultatin përfundimtar të cash-flow.

- **[Përshkrimi i gjetjeve]**

1.5 Tarifat

Ne kemi kërkuar informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës kanalizimeve për tarifat sipas kategorive:

- Familjarë,
- Biznese,
- Institucione.

në lidhje me çështjet si më poshtë, sipas tabelës në vijim:

- furnizimit me ujë;
- kanalizimit të ujërave të ndotura;
- furnizimit të ujit me shumicë;
- tarifave dhe lidhjeve të reja.

Tabela 1. 5

[Vendos tabelën sipas klasifikimeve më sipër]

Gjithashtu në vijim të këtij informacioni, ne kemi verifikuar nëse janë miratuar nga ERRU, nëse ka diferencim sipas zonave dhe sa është ky diferencim, si dhe të kontrollojnë një kampion të rastësishëm në përputhje me procedurat e Urdhrit, për zbatimin e këtyre tarifave gjatë gjithë periudhës që është subjekt kontrolli.

• ***[Përshkrimi i gjetjeve]***

1.6 Klientët

Ne kemi kërkuar informacion mbi klientët e analizuar nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve në lidhje me numrin total të klientëve me matës dhe pa matës dhe shumat e arkëtuara, grupuar sipas kategorive në vijim:

- a) Familjarë,
- b) Biznese,
- c) Institucione.

Tabela 1.6.1

[Vendos tabelën sipas klasifikimeve më sipër]

Gjithashtu, në vijim të këtij informacioni, ne kemi verifikuar nëse arkëtimet rakordojnë me librat kontabël analitikë (libri i arkës, libri i bankës, dhe/ose kartelat e klientëve), si dhe nëse numri i klientëve me dhe pa matës rakordon me numrin e njësisve në përputhje me procedurat e pasqyruara në aneksin e këtij raporti. Ne kemi analizuar për kategorinë e përcaktuar në pikën 1.6. më sipër, historikun e mardhënieve me klientët (arkëtime, faturime, etj) dhe kemi identifikuar klientët që nuk kanë veprime nga 1-5 vite dhe mbi 5 vite si dhe ekzistencën e klientëve pa identitet të paraqitur në tabelën 1.6.2

Tabela 1.6.2

[Vendos tabelën sipas klasifikimeve më sipër]

• ***[Përshkrimi i gjetjeve]***

1.7 Verifikime të tjera

Ne kemi kërkuar informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës kanalizimeve mbi:

1. Prodhimin e ujit;
2. Humbjet e ujit në rrjet (teknike dhe/ose administrative);
3. Sasinë e ujit të shitur/faturuar;
4. Investimet nga burimet e veta;
5. Si dhe të verifikojmë nëse të dhënat sintetike rakordojnë me të dhënat e regjistrave përkatës analitikë.

Gjithashtu, ne kemi kërkuar informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve mbi vlerën e faturuar për bizneset, sipas kategorisë së faturimit dhe tarifës së aplikuar për çdo kategori. Për më tepër, ne kemi verifikuar nëse vlera e faturuar rakordon me librat analitikë kontabël (p.sh totalin e kartelave të klientëve).

• ***[Përshkrimi i gjetjeve]***

2. Klasifikimi dhe verifikimi i informacioneve të lidhura me shpenzimet

2.1 Shpenzimet operative

Ne kemi kërkuar informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve mbi shpenzimet operative si dhe të verifikojë nëse rakordojnë me kartelat analitike në kontabilitet duke rishikuar për keqklasifikime apo zëra të pazakonshëm në lidhje me pagat bruto, me mirëmbajtjen dhe riparimet, energjinë elektrike, karburantin, kimikatet, si dhe në lidhje me shpenzimet e auditimit ligjor, konsulenca ligjore, tatimore, financiare dhe të tjera biznesi, si dhe shpenzime të tjera operative.

- **[Përshkrimi i gjetjeve]**

2.2 Shpenzimet totale

Ne kemi ripërlllogaritur totalin e shpenzimeve operative dhe e kemi krahasuar me atë të pasqyruar në pasqyrat financiare

- **[Përshkrimi i gjetjeve]**

3. Procedura të lidhura me ankesat e konsumatorëve

3.1. Informacion mbi ankesat e konsumatorëve

Ne kemi kërkuar informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve mbi ankesat nga konsumatorët të grupuara sipas natyrës së ankesës. Gjithashtu, ne kemi verifikuar nëse ka pasur një praktikë lidhur me grumbullimin dhe shqyrtimin e ankesave.

- **[Përshkrimi i gjetjeve]**

3.2 Trajtimi i ankesave

Ne kemi verifikuar numrin total të ankesave të marra si dhe numrin e ankesave të zgjidhura, numrin e ankesave të refuzuara, numrin e ankesave pa përgjigje, të dhëna të cilat mbështeten në regjistrin analitik të ankesave.

- **[Përshkrimi i gjetjeve]**

4. Procedura të lidhura me matësat dhe regjistrat e matësive

4.1 Matësat

Ne kemi kërkuar informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve mbi numrin total të matësive për burime dhe puse si dhe kemi verifikuar nëse këto të dhëna rakordojnë me të dhënat analitike të regjistrave të matësive.

- **[Përshkrimi i gjetjeve]**

4.2 Regjistrat e matësive

Ne kemi verifikuar mbajtjen e regjistrit për sistemet e furnizimit me ujë, të ndërtuara nga qytetarët duke pasqyruar të gjitha gjetjet faktike.

- **[Përshkrimi i gjetjeve]**

5. Procedura të lidhura me çështje të tjera

5.1. Transparenca

Ne kemi verifikuar nivelin e transparencës në ngritjen e mekanizmave për furnizimin me ujë të familjeve në nevojë pa pagesë, që sigurojnë të paktën 20 lit/ditë/frymë.

- ***[Përshkrimi i gjetjeve]***

5.2. Verifikime të tjera

Ne kemi bërë verifikime të tjera, që lidhen me natyrën specifike sipas të cilës operon subjekti të miratuara në përputhje me urdhërin nr. 94, datë 27.03.2018.

- ***[Përshkrimi i gjetjeve]***

Aneksi 1 Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyra e Cash-Flow, Buxheti vjetor
[Vendos pasqyrat e nënshkruara dhe buxhetin e nënshkruar në mënyrë të dukshme]

Aneksi 2 Fatura e Raportit të Verifikimit e faturuar nga Audituesi
[Vendos faturën e lëshuar ndaj shoqërisë përkatëse të ujësjellës-kanalizimeve sipas marrëveshjes së dakorduar në letrën e angazhimit]

Aneksi 3 Letra e angazhimit midis audituesit dhe subjektit për Raportin e Verifikimit
[Vendos letrën e angazhimit të nënshkruar nga të dyja palët]

Aneksi 4 Shpaloja e informacionit të detajuar për Audituesin Ligjor, Shoqërinë e Auditimit, bashkimin e operatorëve ekonomikë për 5 vitet e fundit.

[Të shpaloset historiku i partnerëve të angazhimit/audituesve ligjorë të 5 viteve të fundit (të mëparshëm dhe ekzistues si dhe, kur është e mundur, funksionin aktual për secilin), si në rastet kur audituesi është person fizik ashtu dhe në rastet kur kemi të bëjmë me shoqëri auditimi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë shpaloja më sipër bëhet njëlloj për të gjitha subjektet që kanë nënshkruar një marrëveshje të bashkimit të operatorëve ekonomikë]

Aneksi 5 Deklaratat e konfliktit të interesit
[Të shpaloset deklarata e nënshkruar e konfliktit të interesit të të gjithë partnerëve të angazhimit/audituesve ligjorë/ administratorit të firmës audituese dhe stafit kryesor në rastin kur ai/ajo zotëron titullin e audituesit të brendshëm për sektorin publik]

Aneksi 6 Evidenca të lidhura me eksperiencën në ujësjellës-kanalizime
[Të bashkangjitet evidencë lidhur me eksperiencën e audituesit ligjor lidhur me ujësjellës kanalizimet (p.sh kontrata të mëparshme, vërtetime nga ujësjellësat etj)]

Aneksi 7 Evidenca të lidhura me titujt
[Të bashkangjitet referenca e adresës elektronike në regjistrin publik të audituesve ligjorë si dhe një kopje e diplomës/dëshmisë së zotërimit të titullit Auditues i Brendshëm për Sektorin Publik]

Aneksi 8 Lista e procedurave të kryera (detajuar më poshtë)

Aneksi 8 – Lista e procedurave të kryera

1 Procedurat e përgjithshme

1.1 Shpenzimet faktike dhe ato të buxhetuara

1.1.1. Audituesi i angazhuar në përputhje me urdhërin nr. 94, datë 27.03.2018 krahason shpenzimet faktike të vitit ose periudhës sipas librave kontabël me ato të buxhetuara.

1.1.2 Audituesi krahason buxhetin fillestar të vitit me ndryshimet e kryera në këtë buxhet gjatë vitit dhe verifikon miratimin e tyre.

1.2 Inventarizimi fizik

1.2.1. Audituesi verifikon nëse është kryer inventari fizik i aktiveve afatgjata materiale në fund të vitit ushtrimor.

1.2.2. Audituesi verifikon nëse është kryer numërimi i mjeteve monetare në arkë në fund të vitit ushtrimor.

1.3 Detyrimet e prapambetura

1.3.1 Audituesi merr informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës kanalizimeve mbi detyrimet e prapambetura dhe bën verifikimin lidhur me rakordimin e librave kontabël analitikë (kartelat e furnitorëve) duke analizuar edhe ekzistencën e detyrimeve pa identitet.

1.3.2. Në lidhje me këto detyrime duhet të analizohet edhe vjetërsia e tyre:

- a) deri në 1 vit,
- b) nga 1 deri në 5 vjet, dhe
- c) mbi 5 vite

të grupuara në detyrime ndaj:

- OSHEE-së,
- Administratës Tatimore dhe Doganore,
- Institucioneve Buxhetore,
- Institutit të Sigurimeve Shoqërore,
- Punonjësve,
- Çështje gjyqësore,
- Të tjera detyrime nëse janë më shumë se 10 % e totalit të tyre.

1.3.3. Gjithashtu, audituesit ligjorë, shoqëritë e auditimit, apo bashkimet e operatorëve ekonomikë të licensuar për auditimin ligjor, duhet të verifikojnë nëse ka akt-marrëveshje për shlyerjen e çdo detyrimi të prapambetur.

1.4 Plani i biznesit

1.4.1 Marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës kanalizimeve mbi planin e biznesit të përgatitur për huamarrjet nga bankat (nëse ka) dhe krahasojnë të dhënat faktike, sipas pasqyrave financiare më të fundit, duke identifikuar diferencat në rezultatin përfundimtar të cash-flow.

1.5 Tarifat

1.5.1. Marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës kanalizimeve për tarifat sipas kategorive:

- a) Familjarë,
- b) Biznese,
- c) Institucione.

në lidhje me çështjet si më poshtë, sipas grupimit në vijim:

- furnizimit me ujë;
- kanalizimit të ujërave të ndotura;
- furnizimit të ujit me shumicë;
- tarifave dhe lidhjeve të reja.

1.5.2. Në vijim të këtij informacioni, audituesit ligjorë duhet të verifikojnë nëse janë miratuar nga ERRU, nëse ka diferencim sipas zonave dhe sa është ky diferencim, si dhe të kontrollojnë një kampion të rastësishëm prej 40 rastesh për zbatimin e këtyre tarifave gjatë gjithë periudhës që është subjekt kontrolli.

1.6 Klientët

1.6.1 Marrin informacion mbi klientët e analizuar nga shoqëria përkatëse e ujësjellës kanalizimeve në lidhje me numrin total të klientëve (nga të cilët sa janë klientë pa matës) si dhe shumën e arkëtuara, grupuara sipas kategorive në vijim:

- a) Familjarë,
- b) Biznese,
- c) Institucione.

1.6.2. Në vijim të këtij informacioni, audituesit ligjorë duhet të verifikojnë nëse arkëtimet rakordojnë me librat kontabël analitikë (libri i arkës, libri i bankës, dhe/ose kartelat e klientëve), si dhe nëse numri i klientëve me dhe pa matës rakordon me numrin e njësisive, sipas projektit të adresarit.

1.6.3. Analizojnë për kategorinë e përcaktuar në pikën 1.6.1 më sipër, historikun e mardhënieve me klientët (arkëtime, faturime, etj) dhe identifikojnë klientët që nuk kanë veprime nga 1-5 vite dhe mbi 5 vite si dhe ekzistencën e klientëve pa identitet.

1.7 Verifikime të tjera

1.7.1 Audituesit marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës kanalizimeve mbi:

1. Prodhimin e ujit;
2. Humbjet e ujit në rrjet (teknike dhe/ose administrative);
3. Sasinë e ujit të shitur/faturuar;
4. Investimet nga burimet e veta;
5. Si dhe të verifikojnë nëse të dhënat sintetike rakordojnë me të dhënat e regjistrave përkatës analitikë.

1.7.2 Marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve mbi vlerën e faturuar për bizneset, sipas kategorisë së faturimit dhe tarifës së aplikuar për çdo kategori.

1.7.3 Audituesit gjithashtu duhet të verifikojnë nëse vlera e faturuar rakordon me librat analitikë kontabël (p.sh totalin e kartelave të klientëve).

2. Klasifikimi dhe verifikimi i informacioneve të lidhura me shpenzimet

2.1 Shpenzimet operative

2.1.1. Marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës kanalizimeve mbi shpenzimet operative si dhe verifikojnë nëse rakordojnë me kartelat analitike në kontabilitet duke rishikuar për keqklasifikime apo zëra të pazakonshëm në lidhje me pagat bruto.

2.1.2. Marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve mbi shpenzimet operative si dhe verifikojnë nëse rakordojnë me kartelat analitike në kontabilitet duke rishikuar për keqklasifikime apo zëra të pazakonshëm në lidhje me mirmbajtjen dhe riparimet.

2.1.3 Marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve mbi shpenzimet operative si dhe verifikojnë nëse rakordojnë me kartelat analitike në kontabilitet duke rishikuar për keqklasifikime apo zëra të pazakonshëm në lidhje me energjinë elektrike.

2.1.4 Marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve mbi shpenzimet operative si dhe verifikojnë nëse rakordojnë me kartelat analitike në kontabilitet duke rishikuar për keqklasifikime apo zëra të pazakonshëm në lidhje me karburantin.

2.1.5 Marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve mbi shpenzimet operative si dhe verifikojnë nëse rakordojnë me kartelat analitike në kontabilitet duke rishikuar për keqklasifikime apo zëra të pazakonshëm në lidhje me kimikatet.

2.1.6 Marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve mbi shpenzimet operative si dhe verifikojnë nëse rakordojnë me kartelat analitike në kontabilitet duke rishikuar për keqklasifikime apo zëra të pazakonshëm në lidhje me shpenzimet e auditimit ligjor, konsulenca ligjore, tatimore, financiare dhe të tjera biznesi.

2.1.7 Marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve mbi shpenzimet operative si dhe verifikojnë nëse rakordojnë me kartelat analitike në kontabilitet duke rishikuar për keqklasifikime apo zëra të pazakonshëm në lidhje me shpenzime të tjera operative

2.2 Shpenzimet totale

2.2.1 Audituesit ligjor, shoqëritë e auditimit, apo bashkimet e operatorëve ekonomikë duhet të llogarisin sa është totali i shpenzimeve operative.

3. Procedura të lidhura me ankesat e konsumatorëve

3.1 Informacion mbi ankesat konsumatorëve

3.1.1 Audituesit marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës kanalizimeve mbi ankesat nga konsumatorët të grupuara sipas natyrës së ankesës.

3.1.2. Audituesit duhet të verifikojnë nëse ka pasur një praktikë lidhur me grumbullimin dhe shqyrtimin e ankesave.

3.2 Trajtimi i ankesave

3.2.1 Audituesit duhet të verifikojnë numrin total të ankesave të marra si dhe numrin e ankesave të zgjidhura, numrin e ankesave të refuzuara, numrin e ankesave pa përgjigje, të dhëna të cilat mbështeten në regjistrin analitik të ankesave.

4. Procedura të lidhura me matësat dhe regjistrat e matësive

4.1 Matësat

4.1.1 Audituesit marrin informacion nga shoqëria përkatëse e ujësjellës-kanalizimeve mbi numrin total të matësive për burime dhe puse duke raportuar të gjitha gjetjet faktike.

4.1.2 Audituesit verifikojnë nëse të dhënat e pikës 4.1.1 rakordojnë me të dhënat analitike të regjistrave të matësive.

4.2 Regjistrat e matësive

4.2.1 Audituesit rishikojnë mbajtjen e regjistrat për sistemet e furnizimit me ujë të ndërtuara nga qytetarët.

5. Procedura të lidhura me çështje të tjera

5.1. Transparenca

5.1.1. Audituesit rishikojnë nivelin e transparencës në ngritjen e mekanizmave për furnizimin me ujë të familjeve në nevojë pa pagesë, që sigurojnë të paktën 20 lit/ditë/frymë.

5.2. Verifikime të tjera

5.2.1 Audituesit bëjnë verifikime të tjera, që lidhen me natyrën specifike sipas të cilës operon subjekti të cilat miratohen me urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.